



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited / të rrjetit të shpërndarjes së shoqërisë Fabrika Duhana AD Banja Luka / Express Logistic and Distribution EOOD.

Në datën 24 Prill 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të "Marrëveshjes për shitjen dhe blerjen e disa aksioneve, bizneseve dhe asetëve të shoqërisë Bulgartabac Holding AD dhe shoqërive të kontrolluara prej saj". Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 11 prill 2017, synohet të realizohet përfitimi i rrjetit të shpërndarjes së shoqërisë Fabrika Duhana AD Banja Luka si dhe përfitimi i 100% të aksioneve të Express Logistic and Distribution EOOD (së bashku "Target") nga shoqëria British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited ("Blerësi").

Ky njoftim bëhet nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited pasi plotësohen kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar ("Ligji").

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited** është një shoqëri investimesh e kontrolluar nga British American Tobacco p.l.c. Në Shqipëri ajo operon me anë të degës së saj British American Tobacco -Albania SHPK.
- **FDBL-B d.o.o. Banja Luka (FDBL-B)** është një shoqëri e themeluar në Bosnje dhe Hercegovinë e zotëruar plotësisht nga shoqëria BTH nëpërmjet shoqërisë BTB. Aktiviteti kryesor i saj do të jetë kryerja e aktivitetit të shitjes me pakicë të librave, gazetave, revistave, kancelarive dhe cigareve vetëm në territorin e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës.
- **Express, Logistic and Distribution EOOD (ELD)** është një shoqëri shpërndarjeje aktive në Bullgari, e zotëruar plotësisht nga shoqëria BTB. ELD mbulon pikat ku shiten cigare, kioska, markete, stacione benzine, dyqane të specializuara etj. Ajo shpërndan gjithashtu gazeta dhe botime. Aktiviteti i ELD-së kufizohet vetëm në territorin e Bullgarisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me neni 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe neni 12, pika 1 dhe 2 , të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al